



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 143/1 Prot.

Tiranë, më 01.04.2016

V E N D I M

Nr. 32, datë 01.04.2016

“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje administrimin e shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Tiranë”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 62, datë 01.07.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Tiranë”, në lidhje me procesin e inspektimit të administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në institucionin, Këshilli i Qarkut Tiranë,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 31, datë 31.03.2015, “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Tiranë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 62, datë 01.07.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Tiranë”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të inspektimit në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Këshilli i Qarkut Tiranë, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Njësia përgjegjëse në bashkëpunim më Sekretarin e Përgjithshëm, duhet të rishikojnë emërtesat e pozicioneve dhe të bëjë unifikimin e tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, (*Titullari i institucionit të nxjerrë një akt administrativ për rregullimin dhe unifikimin e tyre*)
3. Njësia përgjegjëse në zbatim të nenit 115 të Kodit të procedurave Administrative duhet të bëjë revokimin e akteve të konfirmimit si nëpunës civil, përkatësisht për *****, ***** dhe ***** dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të Këshillit të Ministrave, t’i dërgojë ata për të bërë trajnimin e detyrueshëm të ASPA-s si dhe të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë.
4. Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave dhe të nënshkruhen nga nëpunësi civil, eprori direkt i nëpunësit civil si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm.
5. Të kryhen vlerësimet vjetore të punës për çdo punonjës në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”.
6. Të revokohet akti i deklarimit të statusit të punësimit për ***** dhe të përsëritet procedura e deklarimit të statusit të punësimit. Pas kësaj të bëhet vlerësimi, nëse plotësohen ose jo prej saj, kërkesat e pozicionit të punës, i mbetur ose krijuar pas ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Tiranë.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Urdhrin nr. 143, datë 17.02.2016, të Komisionerit, me anë të të cilit është ngritur grupi i punës, i cili është ngarkuar për t’u paraqitur në subjektin e mbikëqyrjes dhe për të verifikuar nivelin e zbatimit të vendimit paralajmëruar.

Bazuar në urdhrin e mësipërm të Komisionerit, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrur në datën **18.02.2016** dhe iu kërkuar personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore,

nëpunëses *****, dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrative, i nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.62, datë 01.07.2015, të Komisionerit, emërtesat e pozicioneve të punës dhe unifikimi i tyre do të bëhen sipas kërkesave të ligjit nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, në momentin e ristrukturimit të institucionit si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit 147/2015, datë 17.12.2015 *“Për buxhetin e vitit 2016”*, për arsye se administrata e Këshillit të Qarkut Tiranë reduktohet në 10 punonjës.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 3, njësia përgjegjëse ka bërë revokimin e akteve të konfirmimit si nëpunës civil, konkretisht për nëpunësin *****, me Vendimin nr.1, datë 27.08.2015 *“Mbi revokimin e vendimit nr.23, datë 03.02.2015 “Mbi konfirmimin si nëpunës civil të specialistit të marrëdhënieve me publikun në Drejtorinë e Financës, Çështjeve Ligjore dhe Administratës”*; për nëpunësin *****, me Vendimin nr.2, datë 27.08.2015 *“Mbi revokimin e vendimit nr.20, dt.29.01.2015 “për konfirmimin si nëpunës civil të Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Mbrojtjes së Tokës”*; për nëpunësen *****, me Vendimin nr.3, datë 27.8.2015 *“Mbi revokimin e vendimit nr.22, datë 2.02.2015 “Për konfirmimin si nëpunës civil të specialistit të arkivës në Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës”*. Këshilli i Qarkut Tiranë i ka dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, kërkesën nr.1377/1, dt.28.08.2015 për kryerjen e trajnimit të detyrueshëm për tre nëpunësit e mësipërm.
- ✓ Në lidhje me pikën 4, rezultoi se formati i përshkrimit të punës është bërë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* dhe janë nënshkruar nga nëpunësi civil, eprori direkt si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm. Njësia përgjegjëse më datë 14.10.2015 ka përfunduar procesin e plotësimit të të gjithë formularëve sipas Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* dhe konstatoi se formularët ishin pjesë e dosjeve të secilit nëpunës.
- ✓ Në lidhje me pikën 5 të vendimit, rezultoi se vlerësimet vjetore ishin bërë në përputhje me nenit 62 të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimit nr.109, datë 26.02.2014 *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*.
- ✓ Në lidhje me pikën 6 të vendimit, njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Tiranë, rezultoi se ka bërë revokimin e aktit nr. 682/1, dt.11.08.2014 *“Mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarimit të punësimit të *****”* me Vendimin nr.4, dt.23.09.2015 dhe ka bërë deklarimin e statusit të punësimit nëpunës civil i konfirmuar me nr.1763/1, datë 23.09.2015 për punonjësen *****. Grupi i punës konstatoi se nga ana e Komisionit të Ristrukturimit ishin bërë përpjekje për riemërimin e punonjësës pas ristrukturimit, por nuk ishte bërë e mundur një gjë e tillë për shkak të suprimimit të

pozicioneve të punës e për këtë arsye ka dalë Vendimi nr.6, datë 16.01.2015 “Për lirim nga detyra dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të *****”.

Në këto kushte konstatohet se njësia përgjegjëse është në pamundësi objektive për të sistemuar këtë punonjëse.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për implementimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arriti në konkluzionin se Vendimi nr. 62, datë 01.07.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Tiranë”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Këshilli i Qarkut Tiranë**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Këshilli i Qarkut Tiranë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 62, datë 01.07.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Tiranë”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Tiranë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA